

tresat që nuk kanë të bëjnë me punën e policisë, kallëzimet penale, kallëzimet për shkelje të rregullave tjera, lutjet, propozimet, vërejtjet dhe të ngjashme.

Nëse keni njohuri ose dyshoni se nëpunësi policor ka bërë ose po bën veprë penale, ju lutemi që këtë t'ia paraqitni Sektorit për kontroll të brendshëm policor, i cili menjëherë do t'i verifikojë pohimet tuaja.

#### 8. KUJT DHE SI TA LAVDËROJ NËPUNËSIN POLICOR?

- Nëpunësitë policore mund t'i lavdëroni për mirësjellje dhe për përgjegjësinë ndaj jush, dhe/ose sepse në komunikim me qytetarët e respektojnë personalitetin e njeriut, dinjitetin dhe e ruajnë imazhin e Ministrisë, duke e dërguar lëvdatët tuaj në njësinë organizative të MPB-së në të cilën punon nëpunësi policor ose në Sektorin për kontroll të brendshëm policor.
- Është e dëshirueshme që në lëvdatë të theksoni të dhënat tuaja personale dhe ta nënshkruani, kështu që lëvdata të merret në konsiderim me rastin e shpërblimit të nëpunësit policor.

#### 9. KU MUND TË MARR FORMULARIN PËR PARAQITJEN E ANKESËS OSE LËVDATËS PËR PUNËN E NËPUNËSIT POLICOR?

Formularin për paraqitjen e ankesës ose lëvdatës në punën e nëpunësit policor, si dhe broshurën me të gjitha njohtimet e duhura për procedurat, mund ta merrni në çdo stacion policor. Formularin mund ta gjeni edhe në prezantimin zyrtar të MPB të Republikës së Serbisë <http://prezentacije.mup.sr.gov.yu/sukp/sukp.htm>

- Jashtëzakonisht, në rrethana të justifikuar, me kërkesën tuaj me shkrim, formularin mundemi t'ju dërgojmë në adresën e shtëpisë.

#### SELIA E SEKTORIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM POLICOR:

Bulevar Zoran Gjingjiq 104 (Bulevar AVNOJ), 11070 Novi Beograd  
Telefoni: 011/31-31-840  
Faksi: 011/30-08-183  
E-mail: [sukp@mup.sr.gov.yu](mailto:sukp@mup.sr.gov.yu)  
Web faqja: <http://prezentacije.mup.sr.gov.yu/sukp/sukp.htm>

#### DIVIZIONI – Qendra Beograd:

(Për drejtoritë policore: Beograd, Pançevë dhe Valevë)  
Bulevar Despota Stefana 107, 11000 Beograd,  
Telefoni/faksi: 011/329-39-10

#### DIVIZIONI – Qendra Novi Sad:

(Për drejtoritë policore: Novi Sad, Zrenjanin, Suboticë, Mitrovica e Sremit, Sombor, Kikindë dhe Shabac)  
Pap Pavla 46, 21000 Novi Sad, telefoni: 021/488-53-52

#### DIVIZIONI – Qendra Nish:


(Për drejtoritë policore: Nish, Zaječar, Leskovc, Vranjë, Bor, Prokuple dhe Pirot)  
Nade Tomiq 14, 18000 Nish, telefoni/faksi: 018/503-337  
- Zyra në Vranjë:  
Matije Gupca 4, 17000 Vranjë, telefoni/faksi: 017/414-847  
- Zyra në Leskovc:  
Koste Stamenkoviqa 1, 16000 Leskovc, telefoni: 016/251-299  
- Zyra në Prokuple:  
Tatkova 4, 18400 Prokuple, telefoni: 027/324-499 lok. 136

#### DIVIZIONI – Qendra Kragujevc:

(Për drejtoritë policore: Kragujevc, Pozharevc, Jagodinë, Çaçak, Uzhiçë, Kravë, Krushevc, Smederevë, Novi Pazar dhe Prijepole)  
Svetozara Markoviqa 41, 34000 Kragujevc, telefoni 034/379-128, faksi 034/379-168  
- Zyra në Jagodinë:  
Boshka Buhe bb, 35000 Jagodinë, telefoni/faksi 035/242.649  
- Zyra në Novi Pazar:  
37. sanxhaçke divizije bb, 36300 Novi Pazar,  
telefoni 020/314-744 lok. 156

## MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME E REPUBLIKËS SË SERBISËSEKTORI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

## POLICIA NË SHËRBIM TË QYTETARËVE



E falënderojmë misionin e OSBE-së për ndihmën e dhënë gjatë përgatitjes dhe shtypjes së këtij materiali.



Misija u Srbiji

ORGANIZACIJA ZA EVROPSKU  
BEZBEDNOST I SARADNJU

## ANKESAT DHE LËVDATAT PËR PUNËN E POLICISË

## 1. ANKESAT DHE LËV DATAT PËR PUNËN E POLICISË

Mund të ankoheni për punën e policisë nëse keni vërejtur ndonjë parregullsi në punën e nëpunësve policorë, ose nëse mendoni se për shkak të veprimit të tyre të paligjshëm ose të parregullt, janë cenuar të drejtat dhe liritë tuaja, dhe nëse nëpunësit kanë qenë:

- të pasjellshëm ndaj jush;
- kanë përdorur forcë të tepëruar;
- ju kanë privuar nga liria në mënyrë të paligjshme;
- ju kanë penguar që të realizoni të drejtat tuaja;
- ju janë cenuar të drejtat tuaja në ndonjë mënyrë tjetër.

Duke e tërhequr vërejtjen për kinse veprimin joligjor dhe të pashembullt të nëpunësve policorë dhe të punëtorëve tjerë të Ministrisë, ju i ndihmoni policisë që të zgjidhë rastet e keqpërdorimit ose veprimit tjetër të keq, që policia të mundet të ndër marrë masat përkatëse ligjore.

Rekomandohet që ankesën për punën e policisë ta parashtroni 30 ditë nga dita kur ka ndodhur kinse shkelja e të drejtave dhe lirive tuaja.

## 2. SI TË PARAQES ANKESËN PËR PUNËN E POLICISË?

Ankesën për punën e policisë mund ta paraqitni:

- me shkrim;
- me gojë, për çka do të hartohet procesverballi; ose
- në formë elektronike.

## 3. ÇKA DUHET TË THEKSOJ NË ANKESË?

Ankesa juaj duhet:

- të jetë e kuptueshme;
- të përmbajë emrin dhe mbiemrin Tuaj dhe të dhënat tjera personale, duke përfshirë adresën e banimit dhe numrat e telefonit;
- të përmbajë vendin, kohën dhe përshkrimin e veprimit ose të lëshimit të nëpunësit policorë për punën e të cilit ankoheni, dhe të dhënat tjera të dobishme;
- të jetë e nënshkruar me dorën tuaj.

Të gjitha të dhënat nga ankesa juaj, posaçërsisht të dhënat personale, janë konfidenciale.

## 4. KUJT T'IA PARAQES ANKESËN PËR PUNËN E POLICISË?

Ankesën kundër nëpunësit policor mund t'ia paraqitni:

- Drejtorisë policore në të cilën punon nëpunësi për punën e të cilit jeni duke u ankuar;
- Selisë së Sektorit për kontroll të brendshëm policor. Për procedurën e mëtejme në bazë të ankesës Suaj do të njohtoheni me shkrim.

Ankesën mund ta paraqitni personalisht ose përmes përfaqësuesit të autorizuar (p.sh., përmes avokatit tuaj ose organizatës e cila merret me dhënien e ndihmës juridike). Që të mundet dikush t'ju përfaqësojë, duhet ta autorizoni me shkrim.

## 5. ÇKA DO TË NDODHË ME ANKESËN TIME?

Së pari ankesën do ta shqyrtojë eprori kompetent i njësisë organizative të Ministrisë në të cilën është i punësuar polici për punën e të cilit ankoheni.

Eprori i autorizuar do ta zbatojë procedurën në mënyrë të paanshme dhe në pajtim me rregullat, gjatë së cilës do:

- t'ju ftojë dhe do të bisedojë me ju lidhur me pohimet në ankesë,
- të bisedojë me dëshmitarët dhe me personat tjerë për të cilët vlerëson se mund të ofrojnë informata të dobishme;
- të mbledhë dhe do të verifikojë dokumentacionin zyrtar;
- të mbledhë dokumentacionin mjekësor dhe dokumentacionin tjetër;
- të bisedojë me nëpunësin policor për punën e të cilit jeni ankuar;
- të kryejë të gjitha kontrollat tjera të nevojshme.

Afati për mbylljen e kësaj procedure është 15 ditë nga dita e pranimi të ankesës.

Nëse ju pajtoheni me qëndrimin e eprorit të autorizuar lidhur me lëndën e ankesës dhe me rezultatin e kontrollimit të pohimeve në ankesën tuaj, procedura mbyllet dhe konsiderohet e përfunduar dhe për të hartohet procesverballi.

## 6. ÇKA DO TË NDODHË NËSE NUK PAJTOHEM ME QËNDRIMIN E EPRORIT TË AUTORIZUAR OSE NËSE NUK I PARAQITEM FTESËS PËR BISEDË?

Lënda do t'i dërgohet Komisionit për zgjidhjen e ankesave për punën e policisë (në përbërjen të së cilës janë

tre anëtarë: përfaqësuesi i Sektorit të kontrollit të brendshëm, përfaqësuesi i policisë dhe përfaqësuesi i publikut), i cili mëtuajtje e udhëheq procedurën.

- Nëse komisioni konstaton se pohimet në ankesën tuaj janë të bazuara dhe konstaton se ka pasur lëshime në veprim të nëpunësit policor për punën e të cilit ju ankoheni, kundër tij do të ndërmerren masat e përgjegjësive penale, kundërvajtëse, disiplinore, materiale.
- Vendimi i komisionit në procedurën e zgjidhjes së ankesës është përfundimtar.
- Për vendim të komisionit do t'ju dërgohet përgjigja me shkrim, me udhëzime se si t'i mbrohi më tutje të drejtat tuaja nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatin e procedurës.
- Afati i përgjithshëm për zgjidhjen e ankesës për punë të policisë është 45 ditë nga dita e pranimi të ankesës.

Nga ju do të kërkohet që të merrni pjesë në seancën e komisionit, për të cilën do të njohtoheni me ftesën me shkrim.

Nuk jeni të obliguar t'i paraqiteni ftesës për bisedë me eprorin e autorizuar, siç as të merrni pjesë në seancën e komisionit.

## 7. ÇKA DO TË NDODHË ME DREJTIMIT E MIA TJERA POLICISË?

Të gjitha drejtimit të tjera Ministrisë së Punëve të Brendshme që nuk janë ankesa për punën e nëpunësve policorë do t'i zgjidhë Sektori i kontrollit të brendshëm ose njësisë tjetër organizative e Ministrisë, të cilën Sektori e ngarkon me këtë.

- Sektori i kontrollit të brendshëm policor ose njësisë tjetër organizative e autorizuar e Ministrisë menjëherë do t'i verifikojë pohimet tuaja.
- Të dhënat tuaja personale do të konsiderohen jashtëzakonisht konfidenciale, dhe na mundësojnë ne që t'ju kontaktojmë për ndihmë plotësuese.
- Nëse dëshironi të jeni anonim, me këtë e privoni veten nga e drejta për të qenë të informuar për rezultatet e kontrollit të ankesës.

\* Në format tjera të drejtimit Ministrisë së Punëve të Brendshme hyjnë: ankesat anonime ndaj punës së policisë, aktet e personave juridikë të cilat nuk i ka nënshkruar personi i autorizuar, parash-